

MATERIAL MËSIMOR

Në mbështetje të mësuesve të profilit mësimor

KOPSHTARI

Niveli II

NR. 7

Ky material mësimor i referohet:

➤ **Lëndës profesionale:**

“Bimët dekorative dhe aromatike”, kl.12 (L-14-323-12)

Përgatiti:

Terezina Vukzaj

Tiranë, 2018

Tema 1: Rëndësia, roli dhe vlerat e bimëve zbukuruese

Lulet dhe bimët dekorative luajnë një rol të rëndësishëm në jetën e njeriut. Bimët mjekësore



aromatike dhe pemët frutore të egra janë përdorë nga kohët e lashta dhe përdoren edhe sot në mjekësinë tradicionale dhe janë përbërësit kryesorë të shumë ilaçeve që prodhohen nga kompanitë e ndryshme farmaceutike. Edhe në Shqipëri rriten qindra mijëra lloje që paraqesin një burim të rëndësishëm kombëtar dhe kështu ato duhet të ruhen dhe të çmohen si të tilla. Tek lulet dhe bimët e tjera zbukuruese nuk flitet për rendimente të tilla si kv/ha, kg/bimë etj, por për vlera dekorative e mjedisore si dhe për tregues ornamentalë. To i shfaqin këto vlera dekorative nëpërmjet proceseve dhe ndryshimeve biomorfologjike që ndodhin në faza të ndryshme të zhvillimit të ciklit të tyre jetësor, kryesisht gjatë fazës së lulëzimit. Lulet përdoren për vlerat e veçanta dekorative që shfaqin. Ka rëndësi kombinimi i ngjyrave të

petlave me gjethet dhe trupin e bimës, koha e lulëzimit, kohëzgjatja e periudhës së lulëzimit, aroma e lules, puhiza, roli dhe funksioni arkitektonik dhe mjedisor. Bimë të tilla lulore si Trëndafili, Viola, Çiklamini, Tulipani, Gladiola, Mullaga, Lulebora, Lulezjarri, Amarildo etj, përdoren për vlerat ornamentale të lules së tyre dhe kohës së lulëzimit. Disa bimë të tjera shquhen për ngjyrën e trupit dhe degëve të tyre, të tilla janë Plepi që kultivohet për ngjyrën e bardhë të trupit dhe degëve gjatë periudhës së vjeshtës dhe dimrit, Thana dhe Arbutusi për ngjyrën e kuqërremtë të degëve etj. Bimë të tjera paraqesin interes për formën dhe madhësinë e gjethes, janë ato që në praktikë i quajmë bimë gjethore, kultivohen dhe përdoren për bukurinë dhe freskinë e gjethëve të tyre, të tilla janë bliri, panja, rrapi, plepi etj. Disa bimë të tjera kanë interes përdorimi për rolin që luajnë në përmirësimin e ambientit nga insektet, kështu p.sh eukalipsi largon mushkonjat në periudhën e verës, prandaj kultivohet gjithnjë e më shumë në zonat e plazhit, afër kënetave dhe kanaleve kulluese. Shkurret zbukuruese janë një grup i madh bimësh, vlerat dekorative të tyre lidhen me madhësinë dhe dendësinë e kurorës, formën e degëzimit, kohën e lulëzimit, formën dhe ngjyrën e gjethëve etj. Bimët konifere janë një grup tjetër mjaft i përdorur për zbukurimin e ambienteve të jashtme në rajonin e Mesdheut. Janë bimë më gjelbërim të përhershëm, kanë lartësi të ndryshme të trupit dhe kurorës, kanë ngjyra të ndryshme të gjethëve dhe frutave, janë të qëndrueshme ndaj te ftohtit dhe faktorëve të tjerë ekologjik dhe tokësor. Në këtë grup bëjnë pjesë bimë të tilla si Pisha, Bredhi, Dëllinja, Selvia, Leylandi, Tuja etj. Bimët gjethore me gjelbërim të përhershëm, në këtë grup bëjnë pjesë lloje që nuk i rrëzojnë gjethet gjatë periudhës së dimrit. Në këtë grup të madh bëjnë pjesë shkurre dhe bimë të larta si Bushi, Hedra, Ligustra, Manjola, Ilqja, Mështekna etj. Disa bimë graminore përdoren për vlerat dekorative që lidhen me ngjyrën e gjethëve, koeficientin e lartë të vëllazërimit, qëndrueshmërinë ndaj ngjeshjes dhe kushteve të thatësisë, këto bimë mbulojnë gjithë sipërfaqen e tokës, ato mbrojnë token nga erozioni. Këto bimë quhen ndryshe bimë

tokëmbuluese, të tilla janë festuka, terfilet etj. Një grup tjetër bimësh dekorative paraqet interes për faktin se lulëzojnë në periudhën e vjeshtës së vonë, dimrit dhe pranverës së hershme, periudhe e varfër me lule për shkak të temperaturave të ulëta. Në këtë grup bëjnë pjesë bimë barishtore që përdoren për gjelbërimin e lulishteve dhe bordurave si Lulevjesh, Lulegojë, Luledelja, Vjollca dhe shkurre shumëvjeçare si Viburnum, Jasemini, Pirokanëtia etj. Një grup i madh bimësh përdoren për vlerat që kanë lulet dhe gjethet e tyre për krijimin e buqetave. Në këtë grup bimësh bëjnë pjesë trëndafilat, tulipani, gladiola, lulekokëzogu, krizantemat lulemëdha etj. Në vendin tonë, ka patur një traditë në kultivimin e luleve në disa qytete si: Shkodra në kultivimin e karafilave, dahliave, Korça në kultivimin e luleve bulbore si: Tulipani, Zambaku. Qendra të traditës në lultari janë edhe Vlora, Tirana, Durrësi, Permeti. Bimët zbukuruese përfaqësohen nga një grup i madh i bimeve të formave drurore, shkurre dhe barishtore, që dedikohen në zbukurimin e mjediseve ku jeton dhe punon njeriu. Ato shërbejnë në zbukurimin e parqeve, lulishteve, kopshteve private, hapësirave të gjelberta të qyteteve, zyrave, shtëpive të banimit, dyqaneve të ndryshme, etj. Përmirësimi i mjedisit nëpërmjet gjelbërimit është i rëndësishëm, pasi bimët e gjelbërta realizojnë pastrimin e ajrit, pengimin e pluhrave, zhurmave, uljen e nivelit të CO₂ në atmosfere, pra krijojnë një mjedis cilësisht më të mirë për qytetarët. Dashuria e njeriut për bimët zbukuruese është teper e lashtë. Gjatë gjurmëve arkologjike në faqet e shpellave, ku kanë banuar njerëzit e lashtë, janë gjetur gdhendje që paraqesin degë, gjethë ose lule të bimëve që e kanë tërhequr vëmendjen për bukurinë e tyre. Roli i bimëve zbukuruese në jetën e njeriut është i madh. Ato bëjnë hijezimin e sipërfaqeve të shtruara dhe reflektojnë duke ulur ndjeshëm temperaturën dhe rrezatimin termik. Bimët janë filtra të pluhurit dhe gazrave ndotës. Sipërfaqja e gjelbërt urbane përmirëson ajrin duke kapur për çdo ha rreth:

- 0,7 ton oksid karboni
- 2,1 ton bioksid squfuri
- 2,4 ton bioksid azoti
- 6 ton ozon
- 5,5 ton pluhura

Gjithashtu bimët e gjelbërta zbutin zhurmat në zonat industriale dhe pranë rrugëve automobilistike.

Nga pikëpamja estetike ato realizojnë disa funksione:

- Maskim të pamjeve antiestetike të ndërtesave apo objekteve të ndryshme që stonojnë me arkitekturën e qytetit.
- Gjallërim të shtëpive ose mjediseve rrethues në kontrast me sipërfaqet e ngurta dhe ngjyrat monotone të shtëpisë, rrugëve, trotuareve apo ndërtesave.
- Vlerësim dhe nxjerrje në dukje të elementeve arkitektonik si monumentet, ndërtesat etj. Ato shërbejnë si sfond i gjelbërt përreth një vepre arti ose një ndërtese të bukur.
- Unitet në një qytet me ndërtime të stileve dhe epokave të ndryshme.

Bimët kryejnë edhe funksione biologjike.

- Janë habitat i përshtatshëm për rritjen e faunës, shpendëve të ndryshëm dhe kafshëve të vogla.
- Ruajnë tokën nga gërryerja në skarpatat e ndryshme.

Por lulet shprehin emocione të veçanta.

- Shërbejnë për të shprehur një emocion, mirënjohje, falje, dashuri etj. Në këto raste, lule të veçanta shprehin në mënyrë perfekte një ndjenjë që fjala nuk është e aftë ta shprehë.
- Kanë vlerë si komponent kryesor në festat e ndryshme.

Lule të veçanta përdoren në festa të caktuara p.sh: Trendafili dhe Karafili i kuq për Shën Valentino, Zambaku i bardhë në Ditën e Nënës, Krizantema në ditën e Përkujtimit, ndërsa Poinsetia (Ylli i Krishtelindjes) përdoret për festën e Krishtëlindjes etj.

Bimë mjekësore quhen të gjitha bimët që përmbajnë substanca vepruese, të cilat parandalojnë lehtësojnë ose shërojnë sëmundje të ndryshme. Bimët mjekësore mund të mblidhen ashtu siç janë ose mund të merren nga ato vetëm pjesët e veçanta si: lulet, gjethet, rrenjet, frytet, farërat, degët, sythet etj, që janë më të pasura me substanca vepruese. Si bima e tërë, ashtu edhe pjesët apo organet e saj, ne gjendje të tharë, quhen droga mjekësore bimore.

Tema 2: Klasifikimi i bimëve zbukuruese

Klasifikimi i luleve dhe bimëve të tjera zbukuruese ka lindur si domosdoshmëri e përdorimit të tyre në skemat e gjelbërimit të ambienteve të jashtme dhe ambienteve të brendshme me bimët e vazos Specialistet e arkitekturës së mjedisit, punojnë duke u bazuar në grup bimët të cilat në strukturën e gjelbërimit luajnë një rrol pothuajse të njëjtë. Për këtë përdoret nocioni i grupimit të bimëve sipas qëllimit të përdorimit. Në projektim punohet me nocionin e grupit të bimëve që kanë ngjashmëri në vlerat ornamentale që ofrojnë, në ***qëllimin e përdorimit***. Kështu gupohen:

- ***bimët e larta konifere me gjelbërim të përherëshëm*** si: Pinus pinea Italica, Pinus excelsa, Pinus nigra, Pinus maritima, Picea amorica, Picea abies etj,
- ***bimët gjethore me gjelbërim të përherëshëm*** Iex aquifolium, Magnolia grandiflora etj,
- ***bimët drunore gjetherenëse*** Bliri, Rrapi, Albicia, Hipocastanea, Lagestromia,
- ***bimët shkurrore me gjelbërim të përherëshëm*** si: Viburnum sp, Oleandri, Jasmini, Bushi etj,
- ***bimët shkurrore konifere*** si: Picea amorica "Nana", Thuya occidentalis "Little", Picea pungens "Glauc Globoza", Pinus mugo "Mughus",
- ***bimët për ndërtim bordurash*** si: Rozmarina, Ligustra etj, bimë graminore tokëmbuluese etj.

Një klasifikim tjetër është mbi bazën e vendit të kultivimit dhe specifikave më të detajuara për kërkesat që kanë për ***mënyrën e ekspozimit të tyre***. Kështu:

- ***lule për ambientet e brendshme*** ku bëjnë pjesë shumë bimë lulore dhe gjethore si Cyclamen persicum hybrids, Diffenbachia maculata, Euphorbia pulcherrima, Guzmania, lingulata etj.
- ***lule dhe bimë kacavjerrëse*** ku më të përdorurat janë Lespedeza thunbergi, Clematis ibridi, Hedra sp, Actinidia kolomikta, Jasmin sp, Uestria sp etj.
- ***lule dhe bimë të ambienteve të brendshme që varën në tavane dhe mure*** ku bëjnë pjesë bimë të tilla si Sedum lineare "Variegata", Scindapsus pictus "Argyraeus" etj.

Kështu në momentin e kompozimit të bimësisë, projektuesit i drejtohen grupimit të bimëve mbi bazën e vlerave ornamentale, të dhënave të origjinës, kërkesave ndaj dritës, temperaturës dhe tokës etj. Lulet dhe bimët e tjera zbukuruese janë objekt i gjerë i kërkimit shkencor në drejtim të krijimit të formave të reja bimore me përshtatshmëri dhe qëndrueshmëri të mirë. Për këtë qëllim, studiuesit i referohen ***klasifikimit botanik***, rendit, familjes, gjinisë, species, kultivarit dhe formave të tjera të krijuara. Ky orientim ka rendësi për lehtësimin e punës në drejtim të teknologjisë së kultivimit dhe në drejtim të gjetjes së komponentëve prindëror sa më të përshtatshëm dhe rezultativ. Klasifikimit botanik të luleve i referohen të gjitha studimet dhe aspektet e tjera praktike që lidhen me rajonizimin e specieve pasi dihet se kultivarët e luleve nuk kanë ndryshime të thella në lidhje me kërkesat e tyre ndaj klimës dhe tokës. Ndryshimet

ndërmjet kultivarëve lidhen me nivelin e shfaqjes së treguesve ornamental dhe treguesve të vegetacionit të bimës. Ka disa sisteme klasifikimi të luleve dhe bimëve të tjera zbukuruese ku më i përdoruri është ai ***sipas qëllimit të përdorimit***. Mbi bazën e këtij sistemi ato janë:

- Lulet dhe bimët e vazos
- Lulet dhe bimët e fushës së mbrojtur
- Lulet dhe bimët e peizazhit

Bimët dekorative grupohen edhe ***sipas mënyrës së shtimit***. Ato shumëzohen nëpërmjet dy mënyrave: me farë (gjenerative) dhe me copa vegetative. Në natyrë, bimët shtohen me farë, zhardhokë, stolone, kjo mënyrë natyrale e shtimit ka koeficient të ulët shumëzimi dhe nuk i përmbush dot nevojat e tregut dhe konsumit për bimë dekorative. Shtimi me copa vegetative është një mënyrë e papërshtatshme dhe jo efektive për një numër të madh bimësh të cilat prodhojnë pak fara dhe rrënjëzojnë me vështirësi (Tuja, Leylandi, Ilexi etj). Shumimi vegetativ bazohet në aftësinë që kanë qelizat parenkimatike të bimës për tu shndërruar në qeliza meristematike. Ky shndërrim vjen si rezultat e ngacmimeve mekanike dhe dëmtimit të qelizave të gjalla. Totipotenca, çdo qelizë bimore përmban materialin e nevojshëm gjenetik për të dhënë një bimë të re identike me bimën mëmë. Numri më i madh i luleve shtohen nëpërmjet rrugës vegetative p.sh Begonia (me copa gjethore) Saxifraga (me stolone), Orkidetë (me shpatulla), Filodendroni (me përpajna), leylandi (copa) etj.

Mënyrat kryesore të shtimit vegetativ janë:

- Shtimi me copa (mullaga, tuja, rozmarina etj).
- Shtimi me shartim (trëndafili, kumbulla e kuqe etj).
- Shtimi me stolone (saxifraga, viola etj).
- Shtimi me përpanja (lulevilja, jasemini etj).
- Shtimi me shpatulla (tujat, leilandi, gold cresi etj)
- Shtimi me ndarje të bimës (iris, Trëndafilat, krizantemat etj)
- Shtimi me kërcej të metamorfizuar.
- Shtimi me metodat invitro

Tema 3: Teknologjia e kultivimit të bimëve zbukuruese

Lulet janë një lloj dashurie e veçantë për shumë njerëz. Stina e pranverës është ajo stinë që faktikisht na shton më shumë dëshirën për t'u marrë dhe kujdesur për to.



Pranvera është stina e lulëzimeve të mëdha, e luleve shumëngjyreshe dhe më me aromë e vitit. Kjo është koha kur ne mund të admirojmë bukurinë e bimëve dhe luleve të mbjella në vjeshtë.

Por është gjithashtu edhe sezoni kur mund të mbjellim fara të reja, të cilat, me lulëzim e tyre do të mund ta bëjnë kopshtin të bukur deri në vjeshtën e ardhshme.

Koha e mbjelljes në pranverë - Më 21 mars shënohet edhe fillimi i pranverës. Por nuk është e thënë se në këtë muaj mund të mbillet çdo lloj fare. Në qoftë se në shumë pjesë të vendit, pranvera ka ardhur, në të tjera ndodh që toka të jetë ende e mbuluar me bor dhe mbijetesa e çdo lloji të bimëve nuk ka garanci. Disa lule, si trëndafilat dhe lule vjollcat, mund të mbillen fillimisht në një vazo (të mbahen brenda në shtëpi) dhe më pas të zhvendosen në kopsht. Për të tjerat, zambakët dhe gojuku, duhet të prisni ardhjen e temperaturave më të larta për t'i mbjellë jashtë.

Llojet e luleve që mund të mbillennë pranverë - Manushaqet tringjyrëshe janë lule rezistente që mund të mbillen ose në vazo ose direkt në kopsht në fillim të pranverës. Nëse lulet mbillen jashtë, ato do të vazhdojnë të lulëzojnë deri në ardhjen e të nxehtit të verës. Mund të mbillet edhe agulçe, columbine, dhe lule gjaku, të cilat janë lule rezistente edhe ndaj temperaturave të ulëta. Këto lule mund të blihen edhe si fara, por edhe në vazo për t'i vendosur më pas në kopsht.

Mbjellja e luleve në pranverë - Fillimi i pranverës është edhe stina në të cilën fara mund të mbillet edhe në shtëpi. Në këtë mënyrë pritet lulëzimi i tyre për t'i mbjellë më pas në kopsht pas 6 javësh. Lule të tilla si, trëndafilat dhe një pjesë e madhe e bimëve, janë të lehta për t'u mbjellë që kur janë fara. Toka ku do të mbillen lulet duhet të jetë e punuar mirë dhe e lagësht deri kur fidanët mbijnë. Ndërkohë, gjatë ditës fidanët lihen në kopsht, kështu që ato kaliten me erën dhe ngritje-uljet e temperaturës, ndërsa natën futen në shtëpi ose mjedise të mbrojtura deri në ditën e fundit kur do t'i mbillni në kopsht. Fillimisht në mjediset e shtëpisë mund të mbillen domate të vogla, tranguj, rrepa, luleshtrydhe dhe bimë aromatike. Në pranverën e vonë është momenti që të mbillen lulet e verës, gladiola, begonjë, si dhe zambak. Ndryshe nga lulet e pranverës, këto luleo nuk u mbijetojnë dot temperaturave të dimrit, kështu që duhet të mblidhen përpara të ftohtit të vjeshtës. Në fund të pranverës, për t'ia koleksionit të bimëve të gjelbra mbillen lule të tilla si lule monarda, bar pezmi, luleshqerrë, qumështore, mëllagë dhe gjemb gomari. Nëse vetëm një herë mbillen në kopsht, këto lule nuk do të kenë nevojë për shumë mirëmbajtje, përveç krasitjes në çdo dy apo tre vjet.

Lulet e përjetshme - Dëshira e adhuruesve të luleve është që të kenë një kopsht ose ballkon të lulëzuar gjithë vitin. Ndaj lulet që nuk thahen gjatë gjithë vitit janë një zgjedhje shumë e mirë jo vetëm për këtë, por ato kërkojnë pak kujdes dhe pak shpenzime.

Galium verum është një lule e bukur me grupime tufash të verdha të arta. Lule që mbin sapo bie në kontakt me tokën. Kërkon shumë diell dhe zbukuron kopshtin.

Lathyrus pratensis është pjesë e familjes së bizeleve, rritet gjatë gjithë verës dhe më pas kthehet në një mbështjellëse të zezë bizelesh. Ajo rritet në tokë shumë pjellore dhe me shumë diell.

Campanula latifolia është lule në formën e kambanave. Vjen në ngjyrë violë. Gjethet e saj ngjasojnë me gjethet e hithrës, por në këtë rast gjethet nuk djegin.

Linaria vulgaris është lule shumë tërheqëse. Dallohet nga 2 nuancat e verdha. Gjethet e saj janë të ngushta në ngjyrë gri në jeshile.

Kultivimi i luleve në vazo

Kur lulja fillon e vyshket atehere gjeja e parë që duhet bërë është kontrolli i rrënjës së bimës. Nëse vërehet se rrënjët e bimës janë rritur shumë, atëherë duhet ndërruar vazoja sipas hapave të mëposhtëm:



1. Zgjedhja e vazos me diametër 5cm më të madh se ajo e mëparshmja. Nëse vazoja që zgjidhet është më e madhe se sa duhet atëhere bima detyrohet t'i japë përparësi të rrisë me teper sistemin rrënjor sesa pjesën e kercellit, gjetheve dhe luleve. Nëse do përdoret vazo qeramike është mirë që të lihet në ujë 1 ditë para se ta mbillet.



2. Lagia e plehut Nëse plehu që do të përdoret është i thatë, atëherë njomet pak, por jo shumë ujë që plehu të bëhet si baltë.



3. Hiqja e bimës nga vazoja e vjetër. Mire është te ujitet pak para se ta hiqet që te dale me lehtësi. Duke qene te lagura rrënjët e bimes kanë më pak mundëi që të dëmtohen. Bima nxirret lehtë nga vazoja duke e mbajtur në pozicionin horizontal duke e levizur



para - mbrapa si në foto.

4. Shkatërrimi i rrënjës së bimës duke hequr edhe dheun që ka ngjatur në to. Kjo bën të mundur që rrënjët të perhapen me mire në plehun e ri.

5. Vendosja e bimës në vazo, duke patur kujdes që pjesa ku fillon kercelli të jetë 2-3 cm poshtë buzës së vazos. Pastaj mbushim me pleh anet e vazos duke patur kujdes që të mos leme boshllëqe.



6. Ujitja e bimes. Ujisim bimen deri sa uji të dale në pjatën e vazos që kemi vendosur poshtë. Nëse pas ujitjes së parë vëmë re që niveli i plehut ka rënë atëhere shtoj pak pleh të ri. Mos shtoni vitamina apo plehra kimikë në vazo derisa të vini re që kanë dalë filiza të rinj.

Rregullimi i shportave dhe shërbimet që kryhen gjatë vitit

Të gjithë drurët, lulet dhe barërat zbukuruese kanë nevojë për shërbime gjatë gjithë vitit por me shumë se të tjerat kanë nevojë lulet e ambienteve të brendshme ku çdo gjë varet nga shërbimet që kryejmë. Kështu p.sh nëse kemi lule në saksit ato varen nga uji, vendosja në dritë ose hije, plehërimi etj. Shërbimet ndaj tyre janë të shumta, në pranverë mund ***të punojmë tokën*** rreth luleve ose nëse kemi shporta ose saksit punojmë më thellë dheun. Është mirë që ***të shtojmë nëpër saksit një dozë plehu*** i cili lëshon sasinë e nevojshme të lendeve ushqyese që kanë nevojë lulet meqenëse është edhe fillimi i fazës ku bima merr më shumë lëndë ushqyese (fillimi i rritjes). ***Pastrimi i degëve*** është një masë mbrojtëse për të hequr degët e dëmtuara dhe realizuar krasitjen e degëve për 'ti dhënë mundësinë bimës që me rifillimin e fazës së rritjes edhe rigjenerimi i saj të jetë më i shpejtë, më uniforme dhe më i lehtë. ***Spërkatja*** është një tjetër proces që ka të bëjë me dezinfektimin e luleve nga parazitët, që mund të kenë dimëruar në saksit dhe përbëjnë rrezik zhvillimi me ardhjen e stinës së ngrohtë. Një tjetër shërbim është ***ndërrimi i dheut***. Në të gjitha lulet e saksive në ballkon apo dhoma bëhet ndërrimi i dheut. Në vend të dherave të vjetra hidhet dhë i ri, i pasur me lëndë organike i cili për këtë qëllim mund të blihet i gatshëm ose të përgatitet duke përzier dhera me pleh organik. Nëse nuk e kryejmë këtë proces toka varfërohet dhe bima

nuk rritet e shëndetshme. *Vendosja e mbështetjeve* është një proces i domosdoshëm sepse mundëson mbrojtjen e bimës gjatë rritjes, mundëson rritjen e saj në mënyrë të rregullt.

Tema 4: Bimët zbukuruese barishtore një, dy vjeçare

Lule begonia Begonia L. është një gjini e bimëve tropikale, familja Begoniaceae, e cila përfshin rreth 1.600 lloje. Ato janë bimë shumëvjeçare në përgjithësi, shpesh rritur në vazo ose në kopsht, si bimë zbukuruese për bukurinë e luleve. Të gjitha begoniat kanë nevojë të përbashkët kulturor me tokën me lagështi, të butë dhe të pasur në çështje organike, lagështia e lartë mjedisore, ekspozimi hije dhe mbrojtjen e të ftohtë të dimrit. Shumëzimit është nga fara, prerje apo kur është e mundur me ndarjen e tubers dhe rhizomes. Ajo preferon të ftohtë, vende me hije dhe të mos e ndjeshme ndaj acar, nëse toka është e mulched duhet me gjethe pyjore, shumëzimi është bërë nga prerje ose ndarja e rhizomes. Të begonias gunga janë perennials interesante për bukurinë dhe shumëllojshmëri të luleve. Shpesh ato formojnë hibride dhe sjellje të ndryshme. Gjethet janë zakonisht të mëdha zemra-formë jeshile të errët me thekse të kuqe, lobed ose dhëmbëzuar. Lulet ndonjëherë e madhësi të konsiderueshme, janë kryer me kohë rrjedh 20-40 cm, mund të jetë e thjeshtë, gjysmë-dyfishtë ose me dy petals me ngjyrë të butë apo të rrudhur dhe shumë të ndryshueshme nga të bardhë, të verdhë, të kuqe dhe kështu me radhë.

Luleshqerra është bimë barishtore që rritet e lartë 5-15 cm. Emri krahinor: Lule shqere, lule delje. Emërtimi shkencor: *Bellis perennis L.* Gjethet në trajtë rozete në fund të kërcellit. Lulja është e vendosur në majë të kërcellit. Petalet e bardha dhe në mes thekët e dendura me ngjyrë të verdhë. Në livadhet kullimore të kullotave dimërore dhe atyre të vjeshtës. Arrin deri në lartësinë 1200m mbi nivelin e detit. Preferon çeltira pyjesh, sheshe të barëzuar dhe arishta të lëna djerrë, mbin në ledhe arash, buzë rrugësh këmbësore dhe pemëtoje. Pjesa që mbledhet: lulet pa bisht. Periudha e vjeljes: Në periudhën Prill-Qershor. Lulet vilen me dorë dhe futen në trastë. Pastaj ato grumbullohen në thasë të vegjël bezeje dhe transportohen për t'u tharë. Lulet hapen për t'u tharë në ambjente të hijezuar dhe të hapur.

Tema 5: Bimët zbukuruese qepore, zhardhokore dhe rizomatore

Gladiola kultivohet për tregti në një sërë vendesh, ku përfshihen Izraeli e Holanda. Edhe në Shtetet e Bashkuara ka ferma gladiolash, që ua dërgojnë produktet e tyre lulëritësve të apasionuar anekënd botës. Familja e mrekullueshme e gladiolave është zmadhuar dhe përfshin tani më shumë se 2.000 varietete, të cilat paraqiten në çdo ngjyrë, nuancë a strukturë të imagjinueshme. Si e kanë krijuar lulëritësit këtë larmi, në dukje të pafund, të së njëjtës lule?

Kultivimi i gladiolave - përveçse marrin farat e luleve, fermerët e gladiolave mbledhin zhardhokët, pjesa e fundit e fryrë e kërcellit të lules. Ata mbledhin edhe zhardhokët e vegjël dytësorë që rriten mbi zhardhokët kryesorë. Në pjesën më të madhe, gladiolat e kultivuara janë krijuar duke u nisur nga llojet afrikane. Prandaj ato i kanë rrënjët, si të thuash, në tropik dhe janë mjaft të ndjeshme ndaj klimës. Ato mund të mos i përballojnë dot dimrat e ftohtë të disa vendeve, por ia dalin mjaft mirë gjatë muajve të ngrohtë të verës. Në klimë më të ftohtë, zhardhokët duhen nxjerrë nga toka në fund të stinës së rritjes dhe duhen pastruar me kujdes. Do të jetë formuar një zhardhok i ri. Duke hequr zhardhokun e vjetër e të pajetë tamam në fundin e kërcellit, zhardhoku i ri do ta ketë më të lehtë të lëshojë rrënjë. Veç kësaj, duhen hequr edhe

zhardhokët e vegjël sa një kokërr bizele, të mbledhur grumbull mbi çdo zhardhok. Gjatë motit të ftohtë si zhardhokët e vegjël, ashtu edhe ata të mëdhej duhen mbajtur në një vend të thatë e të freskët me temperaturë më të lartë se temperatura e ngrirjes.

Pasi mbillet, çdo zhardhok i vogël do të nxjerrë gjethe të holla dhe nga fundi i stinës së rritjes zhardhoku i vogël do të jetë bërë një zhardhok i pjekur. Kur mbillen stinën pasardhëse, këta zhardhokë japin bimë të rritura e të harlisura me lule. Në klimë të butë, mbjellja mund të nisë në pranverën e hershme. Koha e mbjelljes nuk është edhe aq vendimtare në vendet me klimë të ngrohtë. Më e mira e të mirave është që zhardhokët e vegjël dhe ata të mëdhenj të mbillen në tokë me lagështi e pakëz acide. Ata duhen vendosur në vende ku do të marrin drejtpërdrejt dritën e diellit, pasi gladiolat nuk rriten mirë në hije. Zhardhokët e vegjël mund të shpërndahen në një brazdë tetë centimetra të thellë e pastaj të mbulohen me dhe. Zhardhokët e rritur, nga ana tjetër, duhen mbjellë në një thellësi prej 13 centimetrash., zhardhokët me madhësi mesatare duhen mbjellë rreth tetë centimetra larg njëri-tjetrit dhe ata më të mëdhenj 10,5 deri në 13 centimetra larg.

Zambaku i paqes i njohur ndyshe edhe si spatifiliumi është një lule që mund të dhurohet për të uruar martesën, apo një përvjetor, për shkak të ngjyrës së bardhë të ëmbël që ka. Ai zgjidhet gjithashtu për t'u dhuruar për inagurimin e një aktiviteti ose për blerjen e një shtëpie të re, si një ogur i mirë për një të ardhme plot me lumturi. Për ata që i duan bimët zambaku është lulja dekoruese që i përshtatet çdo ambienti të shtëpisë. Eleganca dhe delikatesa e tij i japin shtëpisë një finesë ekzotike dhe atmosferë relaksuese. Në gjuhën e luleve spatifiliumi do të thotë: “unë do të mbroj”. Kjo simbolikë është zgjedhur me shumë mundësi për shkak të formës së luleve, që mbrohen nga një gjethe në formë shpate. Emri shkencor *Spathiphyllum* rrjedh nga fjalët greke "spathe = shpatë" dhe "phyllon = gjethe". Ndërsa ngjyra e zakonshme e kësaj luleje është e bardha e ëmbël, në disa raste e gjejmë edhe ngjyrë rozë.

Zymbyli është lule natyrale dhe magjeps këdo. Ajo vesh me ngjyrat vjollcë dhe blu lëndinat dhe zonat pyjore të Shqipërisë. Zymbyli njihet si lulja e zanave. Legjenda thotë se nëse vendosni kurorë me lule zymbyli, do të ndiheni të detyruar për të thënë vetëm të vërtetën. Zymbyli është simbol i përlësisë dhe shpesh i mirënjohjes. Kjo lule shpesh shoqërohet me simbolikën e dashurisë së përjetshme dhe qëndrueshmërisë. Rritja e zymbylit në ujë është mënyra më e bukur për t'i dhënë shtëpisë suaj ngjyra dhe aroma nga më fantastiket. Gonxhet e zymbylit kanë një aromë të mahnitshme ndërkohë që ngjyra e tyre me nuanca të rozës dhe vjollcës është krejt unike. Zymbyli kërkon vazo me grykë të vogël sepse i mban lehtë dhe të bashkuar kërcenjët mbi ujë ndërkohë që pjesa e poshtme shijon hapësirën dhe ujin për të cilat ka aq shumë nevojë. Zhardhokun e zymbylit mund ta blini në tufa dhe ta rrisni në vazon përkatëse që të mbajë nën kontroll rritjen e lules. Këto vazo me grykë të vogël dhe bazë të gjërë lejojnë rrënjët e lules të rriten në hapësirë dhe në ujë të bollshëm. Mbusheni vazon me ujë të mjaftueshëm që të arrijë deri tek pjesa e zhardhokut, por mos ta prekë atë. Lini një hapësirë të konsiderueshme mes ujit dhe bazës së zhardhokut i cili nëse bie në kontakt me ujin ka tendencë të kalbet. Pas pak kohësh, rrënjët do të fillojnë të dalin e të zhyten në ujë ndërkohë që zymbyli dalëngadalë do të lulëzojë. Vazon vendoseni në një zonë të errët dhe të freskët deri sa rrënjët të jenë shpërndarë në ujë dhe sythet e bimës të kenë çelur pak. Ujin e enës duhet ta ndërroni dy herë në javë. Më pas, vazon transferojeni në një vend më të ngrohtë dhe me më shumë dritë.

Lule shpata apo Lulja e Gjarprit është një nga bimët më popullore, perfekte veçanërisht për zyra sepse nuk ka nevojë për shumë vëmendje. Kjo bimë nuk është aspak delikate, sepse edhe nëse gjethet e saj thyhen, ajo rimëkëmbet shpejt. Pastron ajrin nga kimikatet e lartpërmendura dhe çliron shumë oksigjen, veçanërisht në mbrëmje.

Tulipani është një lule e madhe dekorative që çel në pranverë dhe mund të rritet edhe në kopsht. Ngjyrat e saj janë të forta dhe të shëndritshme dhe këtu qëndron veçantia e tyre. Tulipanët mund të çelin për shumë vite dhe nuk e humbasin bukurinë e tyre. Njerëzit që kanë tulipane lule të preferuar janë të ëmbël, pasionant dhe shumë bamirës. Përveç bukurisë dhe jetëgjatësisë së saj kjo lule është përdorur dhe për përgatitjen e ëmbëlsirave dhe sallatave të ndryshme. Ngjyrat dhe delikatesa e tyre do t'i japin finesë dhe klas pjatës suaj. Nëse doni të dhuroni një tulipan duhet të jeni i kujdesshëm në përzgjedhjen e ngjyrës, sepse çdo ngjyrë ka simbolikën e saj mijërvjeçare. Tulipani i kuq simbolizon dashurinë e vërtetë dhe pasionin e çmendur dhe të jep mesazhin e një deklarate të fortë dashurie. Tulipani i bardhë simbolizon qiellin, risinë, pastërtinë dhe dashurinë e përhershme. Tulipani i verdhë simbolizon dashurinë e pamundur. Tulipanët me ngjyra të veçanta dhe të shndritshme kanë qënë simbol i familjeve mbretërore për qindra vjet me rradhë, nëse një person ju dhuron një të tillë do të thotë se është i gatshëm të bëjë gjithçka për ju.

Tema 6: Bimët zbukuruese shkurre. Trëndafili

Trëndafili është shkurre zbukuruese deri në dy metra e lartë, me gjemba të gjatë, me lule të mëdha fletë-fletë, të bukura, të mbledhura, me erë të këndshme e në ngjyrë të bardhë, të kuqe, të verdhë etj. Lulja që më shpesh i dhurohet njerëzve është trëndafili. Bima e ka origjinën nga Azia, ku është rritur para mijëra viteve dhe civilizimet e konsideruan si akti i Zotit. Tani, trëndafili konsiderohet si imazh i bukurisë dhe dashurisë, dhe rëndësia e saktë varet nga ngjyra e saj. Trëndafili (gjinia *Rosa*) është ndoshta lulja më e njohur dhe më e pëlqyer. Trëndafilat e kuq janë simbol i dashurisë dhe pasionit, një lloj mesazhi për njeriun që e doni, dhe prezanton kurajo dhe respekt. Trëndafili i bardhë simbolizon bukuri dhe dashuri të vërtetë, dhe së fundi edhe simbolizon qetësinë mendore. Trëndafilat e kuq dhe të bardhë së bashku prezantojnë bashkim, mirëkuptim, dhe plotësim. Trëndafilat portokalli prezantojnë dëshirë të zjarrtë dhe entuziazmin. Trëndafilat e verdhë prezantojnë shoqëri, kënaqësi, lumturi nganjëherë edhe xheloz. Nëse e kombinoni me një trëndafil të kuq ajo nënkupton mendjehapës.



Nuk ka kopsht të bukur pa prezencën e trëndafilave. Ata i gjejmë të mbjellur, pothuajse në çdo kopsht të shtëpive tona. Ata e zbukurojnë kopshtin tonë. Ekzistojnë trëndafila që rriten pak, që jemi mësuar t'i quajmë mini trëndafila, të cilët zakonisht mbillen afër trotuarve dhe në fund të oborreve, pastaj trëndafila të mesëm që rriten mesatarisht dhe ata që rriten shumë lartë të cilët i quajmë trëndafila katërrithës. Eksistojnë edhe shumë lloje të trëndafilave të cilët rriten në formë të atillë që iu ngjajnë pemëve. Disa nga trëndafilat kanë aromë të këndshme, kurse disa të tjerë nuk kanë aromë fare. Shumica e llojeve të trëndafilave kanë origjinë nga Asia, me përjashtim të disave të cilët na vinë nga Afrika, Amerika Jugore dhe Evropa.

Trëndafilat mund të përhapen nga fara dhe në këtë mënyrë janë më të gjatë, më të qëndrueshëm në temperatura të ulëta dhe mund të shumohen shumë shpejt. Në këtë mënyrë zvogëlohet kostoja e blerjes së fidanëve të trëndafilat. Pas marrjes së farës përgatitet vendi për mbjellje. Fara është e përzier me një substrat të lagur në një tas apo të mbajtur mes dy shtresave të letres. Mbyllet në një qese plastike që parandalon tharjen. Procedurat për shtresëzim është e njëjtë me përgatitjen e farës së perimeve ose lulëzimit të luleve. Fara e përgatitur kështu është e gatshme për shtresim

dhe vendoset në raftin e poshtëm të frigoriferit ku temperatura është 5 deri në 7°C. Procesi i shtresimit zgjat rreth dy muaj. Farat nuk vendosen shumë afër sepse bimët e vogla kanë nevojë për hapësirë për t'u zhvilluar. Enët gjysmë të përbëra duhet të jenë në një temperaturë dhome (rreth 20°C), apo vendosen në një dritare nga jugu, për arsye që trëndafilat e kuq kërkojnë më shumë dritë. Pas mbjelljes së farave dhe gjatë rritjes duhet që të kontrollohen rregullisht. Ujitja duhet të jetë e moderuar. Trëndafilat e ri janë shumë të ndjeshëm ndaj lagështirës së tepërt, por edhe ndaj mungesës së lagështisë. Kujdesi ndaj bimëve të reja zgjat deri në pranverë. Në fillim të periudhës së forcimit, trëndafilat e vegjël nuk duhet të vendosen në rrezet e drejtpërdrejta të diellit, për arsye se rrezet e diellit thajnë lulet e trëndafilat, por vendosen nën hije dhe ngadalë mësohen me kushtet e jashtme. Pas kalimit të ngricave, trëndafilat vendosen në kopsht dhe si bimët e tjera. Kur trëndafilat çelin, u hiqen lulet për të lejuar që bima të zhvillojë rrënjën. Trëndafilat mbillen në vjeshtë. Bimët mbillen kur dheu është i thatë dhe i kulluar mire. Trëndafilat duan dheun e thatë dhe neutral me vlera të pH 5.5-6.5. Gjatë vjeshtës toka plehërohet dhe shpërndahet plehu në mënyrë të barabartë, përzihet dheu dhe plehu sëbashku dhe pastaj mbillen trëndafilat. Trëndafilat e vegjël duhet të mbillen në distancë 30×30cm. Fillimisht bëhet plani i gropave 30×30×30cm. Para se të mbillen, bimët mbahen në një kovë me ujë të paktën për 6 orë. Rrënjët shkurohen pak, hiqen rrënjët e dëmtuara dhe me kujdes vendosini në gropat e hapura. Fidani vendoset në mes të gropës duke e mbajtur me njërën dorë. Ndërsa me tjetrën shkrihet dheu në mënyrë të barabartë. Bëhet ujitja pas mbjelljes. Nëse fidani është i plehëruar atëherë gjithë vitin do të ketë filiza dhe do të krijojë degë të mjaftueshme të cilat kur të vijë dimri duhet vetëm të krasiten pak në mënyrë që mos të thyhen nga era. Krasitja e thellë duhet të bëhet në pranverë sepse në të kundërt trëndafilat do të bëhen të egër. Trëndafilat janë preken nga një numër i madh i sëmundjeve, dëmtuesëve dhe çrregullimeve gjenetike.

Dëmtuesit kryesorë janë:

Afidet janë insekte të vogla, zakonisht me ngjyrë të gjelbërt që ushqehen me rritjen e re të bimës. Nuk janë kërcënim i madh, por kolonitë e saj mund të rriten shumë shpejt dhe vërehen lehtësisht. Bima shfaq këto simptoma: gjethe të çrregulluara, “nektar” ngjitës si dhe milingonat që ushqehen me nektarin. Për t'i larguar mund të përdoret uji në të gjithë sipërfaqen e bimës. Nëse nuk funksionon, përdoret sapun anti-insekt ose në mënyrë të sigurt insekticide të cilat luftojnë afidet siç janë: Decis 2.5 EC me materie aktive: Deltametrin duke përdorur 3-5 ml në trejtje prej 10 litra ujë. Spërkatja më e mirë bëhet gjatë orëve të para të mëngjesit ose gjatë mbrëmjes. Luftimi më i mire bëhet në fillim të krijimit të kolonive.

Brumbulli japonez ushqehet me bimë të ndryshme. Mund të mblidhen në numër shumë të madh dhe të shkaktojnë dëme të konsiderueshme. Ky insekt ka ngjyrë bronzi dhe të gjelbër metalike, ushqehet me gjethe dhe dëmton edhe lulet e lastarët e rinj. Insekti i rritur është vështirë të luftohet, por ë këtë rast metoda më e mire është mbledhja e tyre me dorë. Ky insekt mund të luftohet me preparate me bazë pyrethrin.

Kurkuloset e trëndafilat janë insekte të vogla të kuqërremta në ngjyrë kafe, mirëpo mund të shkaktojnë dëme të mëdha, sepse larvat e asaj ushqehen me bimën. Kur rriten ushqehen me lastarë të rinj dhe vendosin vezët përbrenda tyre. Kur të lulëzojnë, lulet do të jenë përplot me vrima. Këto insekte preferojnë trëndafila e bardhë dhe të verdhë, mënyra më e mirë për eliminimin e tyre është mbledhja e tyre me dorë.

Sëmundjet kryesorë janë:

Virusi Mozaik i referohet dy llojeve të viruseve (PNRSV dhe ApMV), shpërndahet përgjatë tërë trupit të bimës, mirëpo nuk ngjitet nga bima në bimë. Mund të duket vetëm në një degë, por e tërë bima infektuhet dhe ka rritje të dobët. Simptomet e këtij virusi ndonjëherë nuk shfaqen,

ndonjëherë shfaqen në forma të mozaikut të verdhë përgjatë vegjetacionit, rrethe apo vija valore të verdha, zverdhje të damarëve si dhe ngjyra lara-lara.

Njolla të zeza në gjethet e trandëfilin është sëmundje kërpudhore, fillon si pikë e zezë me spore përreth të cilët presin kushtet ideale që të zgjerohen. Kur shihen simptomet e sporeve, veprohet me shpejtësi sepse spore të reja prodhohen çdo tre javë. Simptomat e njollave të zeza, janë disa njolla në gjethë që kanë formë rrethore dhe ngjyrë të verdhë përgjatë pjesës së jashtme. Pasi të zverdhët, gjethja bie nga trugu dhe në rast të infektimit të madh bima zhvishet nga gjethet. Kur shihen njolla bima spërkartet me Bordo Miks apo edhe me squfur. Simptomat e sëmundjes shfaqen në gjethë 10-14 ditë pas infektimit. Lagështia ose ujitja gjatë verës, rrit transmetimin e sëmundjes dhe shkakton humbje në gjethë.

Njollat në gjethë, Cercospora nuk është sëmundja e vetme kërpudhore që e sulmon trëndafilin. Kjo sëmundje shkaktohet nga këpurdhat *Cercospora roscola*, nuk është e njëjtë sikur njollat e zeza të mëparshme, por ngjasojnë. Simptomat fillojnë si njolla të vogla rrethore të madhësive të ndryshme, ndryshojnë ngjyrë në pjesët ku vdes gjethi dhe rallëherë paraqiten në pjesë tjera përveç gjethëve. Që ta eliminoni këtë problem, së pari duhet të eliminoni gjethet e infektuara, si dhe mos të harroni gjethet e mbetura në tokë në periudhën e vjeshtës.

Kanceri i rrënjëve shkaktohet nga bakterja *Agrobacterium tumefaciens* që ndërpret aftësinë e bimës për të marrë ushqime dhe ujë. Bimët kanë rritje të dobët dhe lehtë mund të lëndohen më tepër. Bakteri futet në bimë përmes plagëve apo thyerjes, në fillim mund të duken të zbehta mirëpo pasi të rriten marrin formë të parregullt, të fortë dhe të egër. Nuk ka ilaç për këtë gjendje, në rast të tillë shkulet bima me rrënjën dhe shkatërrohet. Këshillohet që në atë vend të mos mbillet për 5 vite, pasi bakteri u mbijetoj dimrave.

Tema 7: Pemët zbukuruese gjethore dhe halore

Bliri është një dru i lartë 20-30m. Emrat krahinorë: Blin, emërtimi shkencor: *Tilia cordata* Mill., *T. argentea* DC. dhe *T. platyphyllos* Scop. Duke qënë se në terrenet e pyjeve takohen të tre këta lloje duhen dalluar për arsye se kanë vlerë tregu të ndryshme. Bliri fletevogël e ka gjethen në formë zemre dhe është pa push nga ana e poshtme. Bliri i argjendët quhet kështu sepse nga ana e poshtme e gjethes ka push të bardhë e me shkelqim si argjend. Bliri fletëgjërë dallohet nga madhësia e gjethes që është shumë e dukshme dhe nga ana e poshtme nuk ka push me shkelqim argjendi por vetëm thjesht ngjyrë hiri të lehtë. Përkatësisht edhe lulet e këtyre blinjëve dallohen nga njëra-tjetra. Lulëzojnë në muajt Qershor-Korrik. Të tre llojet e blinjve takohen në përgjithësi në lartësitë malore deri 1000m mbi nivelin e detit në përzierje edhe me drurë të tjerë pyjorë si panja, frashëri, lisi, krekëza etj. Bliri preferon tokë gurishtore, shkëmbore të rrahur nga dielli e të freskët që ruan lagështi. Pjesa që mblidhet: Lulet të cilat vilen në muajt e çeljes së tyre Qershor-Korrik kur e lejojnë kushtet e motit, kur kanë lulëzuar dy të tretat e gonxheve. Vjelja bëhet me dorë ose gërrshërë të posaçme me ndihmën e shkallëve. Nuk lejohet prerja e degëve apo goditja e tyre me shkop. 30% e luleve duhet të lihen në pemë për ripërtëritje si dhe për bletët. Tharja e luleve dhe gjethëve të blirit bëhet në vende të hapura, gjithmonë në hije dhe për shtrojë duhet doemos beze dhe jo plastmas. Tharja në tharës të posaçëm lejohet deri në temperaturë 40°C për të ruajtur ngjyrimin e verdhë në të gjelbër të çelur. Ambienti i tharjes duhet të jetë i siguar nga ndotjet e pluhurave apo ndotje të tjera.

Dëllinja është shkurre me lartësi normale 1-3 m dhe gjelbërim të përhershëm. Është dy llojesh: e zezë dhe e kuqe, por dëllinja e kuqe mblidhet shumë rrallë. Emrat krahinorë: Gllinja, Dllinja

Emërtimi shkencor: *Juniperus communis* L. dhe *J. oxycedrus* L. Njihen nga të gjithë njerëzit. Ndryshimi është tek ngjyra e kokrrave. Përhapet në rajone të kufizuar duke krijuar dendësi të madhe në numër bimësh; po ashtu rritet edhe në përzierje me shkurret e tjera. Pjesa që mbledhet: frutat në Shtator-Shkurt, kur kanë marrë ngjyrën e plotë të pjekurisë së tyre. Dëllënjat vilen duke shtruar fillimisht një beze të madhe në tokë përreth bimës. Pas kësaj fillon shkundja e degëve me dorë. Në këtë mënyrë kokrrat bien në bezen e shtruar. Kokrrat e mbetura pas shkundjes së kurorës vilen me dorë. Kokrrat e grumbulluara hapen për t'u tharë në një shtresë 1-2cm në vende të mbrojtur nga ndotjet dhe që ajrosen. Tharja zgjat pasi lagështia e frutave të mbledhura duhet të ulet nga 30 - 20 %. Ambalazhimi i produktit bëhet në thasë bezeje të pastër.

Tema 8: Vleftshmëria ekonomike e prodhimit të bimëve zbukuruese

Një trëndafil i rritur në vend kushton 150 - 300 lekë. Ai i ardhur nga importi kushton të paktën 500 lekë. Zbukurimi me lule i tarracës së një vile përllogaritet deri në 250 mijë lekë. Gjithçka mund të gjeni në tregun shqiptar, deri dhe lule nga Kina apo Sri Lanka dhe Andora. Është një biznes që vitet e fundit ka nisur të rigjallërohet edhe në Shqipëri. Biznesi i luleve konsiderohet fitimprurës, por është me një rrezik të lartë, pasi janë bimë të gjalla që duan shërbime dhe mirëmbajtje të vazhdueshme. Në Shqipëri tregu vendas i prodhimit të luleve (nga ato të prera, trëndafila e deri te shkurret apo bimët e larta) është i ulët, mbulon pothuajse 20-25% të nevojave, pjesa tjetër importohet. Vendet që Shqipëria importon janë Italia, Greqia dhe Holanda. I vetmi vend ku në eksportojmë është Kosova dhe sipas të dhënave, ky eksport ka qenë në shifra shumë të ulta, kryesisht për lule të prera, pra për buqeta për qëllime eksportimi. Në vendin tonë sot veprojnë 5 shoqëri me shumicë të prodhimit dhe shpërndarjes së luleve, që janë të shpërndarë në qytete si, Tirana, Durrësi, Lushnja dhe Kavaja. Tregtuesit e luleve e shohin këtë biznes si tepër të vështirë, por pranojnë se tashmë ndodhen në rrugë të mbarë. Në Shqipëri mungon pothuajse baza trashëgimore e këtij biznesi, mungon kultura e kultivimit të tyre për qëllime fitimi, por edhe i blerësve. E përballë kësaj situate çmimet e shitjes së luleve vijnë gjithnjë duke u rritur, sidomos në raste festash, me rreth 5–10%. Shitësit pranojnë se fitimi prej këtij biznesi është sezonal, ndaj dhe luhatjet e çmimeve nuk i shmangen dot këtij koncepti. Ndryshe nga çfarë ndodh me lulet e prera, tregu i bimëve të tjera është më i pasur si nga sasia, ashtu edhe nga numri i vendeve nga importohen. Italia edhe në këtë rast kryeson vendet importuese e ndjekur nga Greqia dhe Holanda. Bimët më të shtrenjta, aty ku edhe fitimi është më i lartë, janë ato që quhen bimët mëmë, siç janë shqiponja apo edhe fikusi. Çmimet në shitje për këto bimë variojnë nga 25 mijë-30 mijë lekë, ndërsa fitimi përllogaritet sipas tregtarëve deri në 5 mijë lekë për një copë. Por tregu i luleve në Shqipëri nuk është i qëndrueshëm. Fitimi është nga 10 - 20% të xhiros totale. Importohen kryesisht bimë në vazo, lule të prera për zbukurime, nga Italia, Greqia dhe Holanda. Detyrimet doganore, që paguhen janë 2% e totalit të mallit të importuar, taksë 20% si edhe detyrime të tjera që lindin si pasojë e të qenit biznes i madh. Fitimi më i madh është në shërbimet që kryejnë për rregullimin e ambienteve të mëdha, si hotele apo vila shumëkatëshe. Zbukurimi me lule i tarracës së një vile, përllogaritet në vlerë deri në 250 mijë lekë, por gjithçka varet nga sipërfaqja e gjelbëruar. Çmimet më të larta janë padyshim në sistemimin e një lulishteje, e cila luhatet nga 400 mijë - 600 mijë lekë, ndërsa në rastin e një hoteli, çmimet luhaten nga 250 mijë - 400 mijë lekë. Vetëm një bredh zbukurues me një moshë 5-vjeçare e rritur në Shqipëri kushton rreth 3,500 lekë, ndërsa e importuar nga jashtë çmimi shkon në rreth 7 mijë lekë. Duke u ndalur te lulet më të vogla, ato që quhen për zbukurim, një vazo

kushton në shitje rreth 500 lekë. Stina e dimrit është koha kur lulet importohen pothuajse tërësisht, pasi në vend kultivimi i luleve bëhet në mënyrë artizanale dhe kjo pengon rritjen e tyre në të gjitha stinët. Në verë, çmimi i luleve bie ndjeshëm për shkak edhe të rritjes së prodhimit. Në këtë kohë prodhimi vendas përqendrohet kryesisht te lulet, si trëndafili, gladiolat, nerçiza apo edhe krizantemat. Në rastin e një buqete me rreth 30 copë trëndafilash, kostoja e saj shkon nga 6 mijë - 8 mijë lekë. Rreziku i këtij biznesi është i pranishëm si për shkaqe natyrore, ashtu edhe për shkak të mënyrave primitive të kultivimit apo edhe rritjes. Të kujdesesh për një lule në vazo, kostoja shkon nga 20-30 lekë, duke përfshirë këtu shërbime për dheun, ujtitjen apo edhe mbrojtjen nga sëmundje të ndryshme. Kenia ka sfiduar tregtarët e mëdhenj italianë për shkak të çmimeve të ulëta që ofron në këtë treg. 60% e tregut europian dominohet nga lulet që vijnë nga Kenia, 38 mijë tonelatë, janë importuar vitin e kaluar në të gjitha vendet e Europës, kryesisht trëndafila me një vlerë prej rreth 100 mijë dollarësh. Sipas specialistëve italianë, shkaku është se punëtorët kenianë, janë forcë e lirë pune, të gatshëm të rrisin lule në kushte të vështira dhe kjo është arsyeja e dominimit të tregut. Por në mbarë Botën ky treg ende konsiderohet i vogël. Të paktën në vitin 2004 në SHBA, shitjet e luleve natyrore u përlllogaritën në rreth 8 milion usd, ndërsa për tregun ndërkombëtar në total shitjet e luleve kapën shifrën prej rreth 19.4 miliard usd të shpenzuar nga blerësit.

Tema 9: Bimët zbukuruese të destinuara për prerje

Karafili (*Dianthus caryophyllus*) është lule e gjinisë *Dianthus*, shumë romantike e vlerësuar në Shqipëri në rajonin e Shkodrës dhe në shumë qytete shqiptare. Emri shkencor i karafilave *Dianthus* ka prejardhje nga greqishtja, e lashtë “Dios” perëndi dhe “anthos”- lule, që do të thotë “Lulja e Perëndisë”. Karafilët janë shumëgjyresh, të kuq, të bardhë, të verdhë, ngjyrë vjollce apo edhe me lara. Në botë ekzistojnë rreth 300 lloje të karafilëve të përhapura gjithandej dhe Shqipëria është një vend që ofron kushte ideale për këto lule të mrekullueshme. Dy mënyra të thjeshta për të mbjellë karafilin në kopshtin ose në vazot e shtëpisë suaj janë:



Mbjellja me fara - farat e karafilit gjenden në dyqanet e luleve ose në farmacitë bujqësore. Farat mbillen në pranverë. Toka duhet të mos jetë shumë e lagur. Fara mbillet 30cm larg njëra tjetrës. Mund të përdoren vazo të gjata drejtkëndëshe në ballkonet tuaja. Farat futen në tokë dhe mbulohen me gjysëm centimetri tokë. Spërkaten farat herë pas here me ujë për të siguruar lagështi. Farërat duhet të mbijnë në 2-3 javë.

Mbjellja me copa e karafilit - priten degëzat e karafilave nga bima të lulëzuara dhe të shëndetshme. Në mënyrë ideale, degëza duhet të ketë 2-3 gonxhe karafili. Këputet degëza menjëherë nën një nyje të kërcellit. Priten gjethet nga gjysma e poshtme e degëzave të karafilit që ushqimi i tokës të shkojë tek rrënjët pa pengesa. Mbushet vazoja me rërë të trashë. Ujitet me kujdes. Zhytten degëzat në gjysëm thellësie brenda në rërë. Çdo gjethe që prek në rërë pritet ose këputet. Vendoset ena në një vend ku do të marrë rrezet e diellit. Me anë të një shisheje ujitëse sprucojmë çdo ditë për të mbajtur rërën me lagështi. Zhvendosen copat e mbjella në një vazo me

dhe' të pasuruar me pleh organik ose një vend me diell në kopsht. Këshillohet mos ujitja e tepërt e bimës.

Tema 10: Zgjedhja e bimëve dhe materialeve ndihmëse për buqeta

Për buqeta lulesh përdoren teknika dhe rregulla të caktuara për t'i formuar ato sipas rastit. Këto rregulla orientojnë profesionistët të ndërtojnë gjeometri të sakta dhe tërheqëse. Hapat më të rëndësishëm që duhet të ndërmerren në ndërtimin e një buqete çfarëdo janë:

- **Rrotullimi i vazos.** Kjo shërben për të pozicionuar sa më mirë vazos në tavolinën e punës për ta mbushur me kujdes.
- **Mbjellja e materialit vegjetativ.** Vendosija bëhet duke imagjinuar një pikë në qendër të vazos. Ekuilibri i vendosur që në fillim për bimën sjell një rritje normale të saj në të ardhmen duke eliminuar forcat negative centrifugale që mund të krijohen në brendësi të saj.
- **Përcaktimi i seksioneve midis luleve dhe gjetheve.** Është një ligj i rëndësishëm në kombinim, për të shpërndarë elementët e buqetës ose vazos sipas ngjyrave. Kjo teknikë konsiston në ndarjen e përbërësve në sektorë të dallueshëm që janë:
 - pjesa e plotë që do ta quajmë 8/8
 - pjesa e mesit 5/8
 - pjesa e poshtme 3/8.

Lartësia e ndarjes është e matur në mënyrë të tillë që shumica e dy pjesëve të mesme të japë lartësinë totale ($5+3=8$). Në këto tre faza duhet të vendosen elementët kryesorë të buqetës dhe kompozimit në mënyrë të tillë që tre lartësitë të kenë ekuilibër si në lule ose edhe në ngjyrat e përdorura. Nëse përdoren tri lule në gjithë lartësinë duhet t'i ndajmë dy pjesët e mbetura me dy lule në mes dhe një në fund.

- **Të luajmë me gjethet,** në mes të vazos mund të vendosim edhe gjethë kjo edhe për të maskuar disi vazos por edhe për të rregulluar volumin e buqetës. Gjethet janë element i rëndësishëm por shpesh janë nënvlerësuar në fazën kompozuese sepse janë konsideruar elementë rutinë. Në fakt është i mundur përdorimi i tyre në bazë të kompozimit për të marrë efekte estetike të pëlqyeshme, siç është rasti i përdorimit të gjetheve. Mund të përdoren tipe të ndryshme gjethesh sipas qëllimit të formimit të buqetës. Për paketimin e buqetës përdoret teknika e lidhjes së tyre. Shkurtohen degët e poshtme uniformisht dhe vendosja e tyre në buqetë bëhet një e nga një dhe në të njëjtën lartësi. Sapo të përfundojë grumbullimi i luleve bëhet lidhja e tyre me fije të ndryshme me ngjyra sipas dëshirës.

Paketimi i luleve duhet të plotësojë buqetën dhe të mos jetë theksi kryesor. Ai duhet të theksojë bukurinë dhe elegancën e ngjyrave dhe të fshehin defekte ose mangësi. Lulet nuk duhet të jenë të mbështjella plotësisht në celofan, letër ose me material të tjera paketimi. Për dekor përdoren elementë natyrore.



Paketimi është plotësues dhe nuk duhet parë i shkëputur. Një metodë e rrumbullakët e paketimit do të shtojë dendësi, spirale, do të bëjë një buqetë të harlisur. Gjëja kryesore janë elementët dekorative. Ai është dytësor dhe vetëm shton më shumë ngjyra dhe thekson vërtetet. Veprimet për të kompozuar një buqetë të bukur janë:

- Menjëherë përgatitet letra e paketimit apo ndonjë gjë tjetër që ju pëlqen, gërshërët, kasetat dhe objekte dekorative (harqet ndryshme, shirita, rrjetë, dhe kështu me radhë).
- Krijohet fort baza e buqetsë në shportë: kështu lulet nuk do të prishen dhe do të merret një vëllim shtesë.
- Zgjidhet letër ambalazhi ose letër të valëzuar. Kjo e fundit humbet shpejt pamjen e saj të mëparshme. Vendoset materiali mbështjellës dhe me kujdes ndahet në gjysmë. Lule duhet të vendosen në mënyrë që rrjedhja të mbetet e hapur.
- Mbyllet me kujdes buqeta në të dy anët dhe fashohet me një fjongo. Buqeta mund të zbukurohet me flutura dekorative, harqe, por në asnjë rast nuk duhet mbingarkuar përbërja e saj.



Materiale për përgatitjen e buqetae

Tema 11: Bimët zbukuruese për ambiente të brendshme

Bimët prodhojnë oksigjen. Ky është padyshim argumenti më i fortë në favor. Pranohet gjërësisht që kur shumë njerëz ndajnë të njëjtin ambient, veçanërisht në zyrë, krijohet një atmosferë mbytëse. Si rrjedhojë shumë njerëz kanë dhimbje koke të shpeshta si dhe ndihen përgjithësisht më të lodhur.



Zamia

Arsyeja përse ndodh kjo është mbiprodhimi i dioksidit të karbonit. Bimët prodhojnë oksigjen dhe rrjedhimisht hapësira e përbashkët do të jetë më e freskët. Dracena është një prej tyre.



Dracena

Pastrojnë ajrin. Hapësirat e brendshme zakonisht kanë një përqendrim të lartë mikrobesh dhe bakteresh që gëlojnë në ajër. Disa bimë kanë aftësi disinfektuese dhe pastruese të ajrit.

Mbrojnë shëndetin e syve. Kjo pikë vlen veçanërisht për bimët në zyrë. Puna përpara kompjuterit mund të ketë një ndikim negativ në shikimin tonë dhe sidomos në shëndetin e përgjithshëm të syve. Bimët arrijnë të zvogëlojnë pasojat negative sepse ato përthithin një sërë kimikatesh. Për



Palma Bambu

më tepër ato kanë ngjyrë të gjelbër dhe të gjithë e dimë që e gjelbra ka një efekt qetësues dhe freskues për sytë tanë. Zamia është një prej tyre.

Lagështia në ajër. Kondicionerët dhe ngrohësit kanë tendencën të thajnë ajrin. Duke qenë se bimët kanë nevojë për ujitje, ato e mbajnë mikroklimën rreth tyre të lagësht, duke përmirësuar kështu cilësinë e ajrit.

Neutralizojnë toksinat e dëmshme për shëndetin tonë. Shumë prej bimëve neutralizojnë toksinat që mbipopullojnë ajrin në hapësirën e brendshme përfshirë gazrat që vijnë nga rruga ose

makinat, benzolin (që gjendet tek bojërat dhe tymi i cigares) Amoniakun (që gjendet në solucionet e pastrimit shtëpiak dhe pjesët kompjuterike) Ksilenin (që gjendet tek plastika dhe ngjitësit), Trikloroetilenin (tek bojërat, boja e printerit, llaku etj), Formaldehidina (tek mobiljet, tymi i cigares dhe plastika). Palma Bambu është një prej tyre.

Kanë një efekt antistres. Bimët, veçanërisht ato që kanë një aromë të lehtë siç janë mentja, borziloku, rigoni dhe të tjerë kanë një efekt aromaterapeutike dhe antistres. Ato nuk i rëndojnë shqisat tona dhe rrisin aktivitetin e trurit, thelbësore për produktivitetin.

Filtrojnë duhanin. Disa bimë janë fantastike për tu vendosur në zona ku njerëzit pijnë duhan. Ato funksionojnë si filtër për të përthithur kimikatet që gjenden tek tymi i duhanit. Megjithatë herë pas here, edhe këto bimë kanë nevojë të qëndrojnë në ajër të pastër që edhe ato të marrin frymë lirisht.

Sansevieria, ose siç njihet ndryshe **Lule shpata** apo Lulja e Gjarprit



Luleshpata

është një nga bimët më popullore. Është perfekte veçanërisht për zyra sepse nuk ka nevojë për shumë vëmendje. Kjo bimë nuk është aspak delikate, sepse edhe nëse gjethet e saj thyhen, ajo rimëkëmbet shpejt. Kjo bimë pastron ajrin nga kimikatet e lartpërmendura dhe çliron shumë oksigjen, veçanërisht në mbrëmje.



Zambaku i paqes

Palma bambu është fantastike për të filtruar ajrin nga kimikatet e dëmshme. Nëse e vendosni atë pranë mobiljeve të lyera me llak, ajo arrin të avullojë kimikatet e dëmshme.

Zamia e njohur si “xhevahiri i Zanzibarit” është shumë e bukur dhe e mrekullueshme për t’i rezistuar temperaturave të ulëta. Kjo bimë detoksifikon ajrin mjaft mirë. Megjithatë, të gjitha pjesët e kësaj bime janë helmuese ndaj nuk është e përshtatshme për dhoma ku qëndrojnë fëmijë apo kafshë.

Zambaku i Paqes apo *Spathiphyllum*. Kjo lule ka nevojë për pak më shumë vëmendje se të gjitha bimët e tjera në këtë listë, veçanërisht në ujitje. Në këmbim, ajo do të pastrojë ajrin përreth shumë më shpejt


se të tjerët. Ashtu si edhe Lule shpata, Zambaku i Paqes njihet për aftësitë e tij në largimin e toksinave të rrezikshme nga ajri. *Chlorophytum* e njohur ndryshe si **Bima Merimangë** është një nga bimët më rezistente që egziston. Ajo mund të jetojë pa ujë për më shumë se një muaj. Kjo bimë është e shkëlqyer për të pastruar ajrin në zyrë ose në dhomë. Ajo arrin të largojë një sërë kimikatesh dhe toksinash (të cilat i përshkruam më lart) nga ambientet e brendshme dhe çliron sasi masive të oksigjenit. Kjo bimë është e sigurt në hapësira që frekuentohen nga fëmijët dhe kafshët.



Bima merimangë

Dracena ose Yuça janë bimë të rritur në shkretëtirat e Meksikës. Ato nuk jetojnë dot pa dritën e diellit. Nga ana tjetër, këto bimë ia arrijnë t’i mbijetojnë ndryshimeve të klimës dhe mungesës së ujit. Ato janë fantastike për të pastruar ajrin.

Ficus Benjamina adhuron dritën e diellit, lagështinë e moderuar por nuk ka tolerancë të lartë ndaj mbiujitjes. Fikusi është shumë efektiv në pastrimin e ajrit të brendshëm sidomos në zonat e mbipopulluara. Kjo është një nga arsytet përse mjekët rekomandojnë fikusin për kopshtet e fëmijëve. Pra, bimët janë shumë të mira për mjediset ku qëndrojmë, prandaj gjithmonë ndiqet rregulli i artë “sa më gjelbër aq më mirë”.



Fikus

Tema 12: Hapësirat e gjelbra

Pozicionimi gjeografik, klimaterik dhe fiziko-territorial e kane vendosur Tiranën në listën e qyteteve të privileguara nga natyra. Ajo ka formën e një amfiteatri të zhytur mes gjelbërimit që formon kurora e malit të Dajtit dhe e kodrave të vendosura në tre anët e tjera. Vetë struktura dhe etapat e ndërtimit të qytetit kanë qenë favorizuese për përçimin e gjelbërimit në brendësi të qytetit në formën e parqeve dhe hapësirave të gjelbëruara masivisht. Është e rëndësishme që të

kuptohet që prania apo jo e gjelbërimit në mjediset urbane nuk lidhet vetëm me cilësinë fizike të mjedisit përreth apo me shëndetin fizik të qytetarëve. Një faktor tjetër indirekt por njëkohësisht mjaft i rëndësishëm, është ndikimi pozitiv që ka gjelbërimi në gjendjen psikologjike dhe mirëqenien mendore të qytetarëve. Një sërë studimesh tregojnë se mjediset publike cilësore ndikojnë pozitivisht në vlerën e pronave në afërsi të tyre. Gjithashtu mjediset e gjelbëruara në afërsi të mjediseve tregtare tërheqin një numër më të madh klientësh të cilët harxhojnë më tepër kohë në këto mjedise dhe janë të gatshëm të paguajnë më tepër për mallrat. Në përgjithësi mjediset estetikisht të bukura nga pikëpamja e arkitekturës e peizazhit përçojnë tek blerësit ndjenjën e respektit dhe përkujdesjes nga ana e shitësve gjë që reflektohet në frekuentimin më të shpeshtë dhe disponibilitetin për të paguar më shumë për mallrat e blera.

Në qytete, hapësirat e gjelbra luajnë një shumëllojshmëri funksionesh si: oksigjenimi, hijezimi, kënaqësia estetike, rikualifikimi, rregullimi i regjimit të ujërave, kapja e CO₂ etj. Bimësisë i atribuohet shpeshherë efekti i “purifikimit” të ajrit nga ndotësit atmosferikë. Problemi i cilësisë së ajrit përfaqëson në mjedisin urban një nga elementët kritikë mjedisorë, edhe në lidhje me temën e shëndetit publik dhe kontributin e hapësirave të gjelbra në përqendrimin e ndotësve atmosferikë. Për këtë arsye është e nevojshme që edhe tek ne ashtu si në shumë vende të tjera të realizohen fushata të shoqëruara me aksione konkrete për shtimin e hapësirave të gjelbra dhe pyllëzimin në hapësirat urbane. Studimet e zhvilluara në qytete të mëdha tregojnë se si hapësirat e gjelbra urbane ndikojnë në largimin deri në 100% të grimcave PM₁₀ dhe shumë gaze të tjerë. Pra një mbulesë e mirë me pemë në qytet mund të ndikojë në mënyrë të rëndësishme në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Në strukturën përbërëse të qytetit dallohet qarte një ndarje midis pjesës veriore (e ndërtuar në mënyrë të dendur) dhe jugore të tij (ku janë vendosur përgjithësisht parqet dhe lulishtet). Të vendosura brenda qytetit ose në afërsi të tij, ata përbëjnë pikat më të vizituara nga qytetarët. Sipërfaqja kryesore e gjelbër dhe atraktive për banorët e kryeqytetit, është Parku i Tiranës i krijuar në vitet '60 me sipërfaqe 288 ha. Sipërfaqe të tjera të gjelbëruara në Tiranë janë ‘Parku Rinia’, parku përballë Parlamentit, lulishtja në afërsi të Bankës së Shqipërisë, një sërë lulishtesh të shpërndara në brendësi të blloqeve të banimit si dhe parku përgjatë Lanës i cili iu është rikthyer banorëve të kryeqytetit. Parku Rinia, i vendosur shumë pranë qendrës së qytetit pas rikonstruksionit është frekuentuar gjithmonë e më shpesh. Karakterizohet nga një mobilim i lehtë urban dhe nga një hapësirë bari integrale si pjese e peizazhit.

Në qytetin e Tiranës infrastruktura e gjelbër prej 1.996.432m² ndahet në:

- Parqe e lulishte të qytetit, 277,304m² (pa përfshirë 6,220m² sipërfaqe të zënë)
- Parqe periferike, 1,719,128m² (Parku i Madh i Tiranës, Varrezat e Dëshmorëve të Kombit, Kopshti Zoologjik)

Drurë dekorativë që janë mbjellë si gjelbërim rrugor dhe në sipërfaqet e rikonstruktura në parqe dhe lulishte janë në total 8300 në 38,120 ml gjatësi, të shpërndara këto në 56 rrugë e bulevarde të qytetit të Tiranës:

- Në sipërfaqe ku është kryer rikonstruksioni i plotë, 1011 drurë
- Në sipërfaqe ku është kryer rikonstruksioni i pjesshëm, 5812 drurë
- Në gjelbërimin rrugor në 25,080 ml gjatësi, 6756 drurë

Parku i Dajtit është një ndër zonat më të rëndësishme në Shqipëri për shkak të trashëgimisë së pasur dhe shumëllojshmërisë së faunës së egër. Kjo vjen si rezultat i gjerësisë gjeografike dhe lartësisë mbi nivelin e detit, shumëllojshmërisë dhe shoqërimeve bimore.

Parku i Liqenit është një pjesë e rëndësishme dhe e njohur për qytetin. Ai është një peizazh që ka evoluar me kohën, i pasur në asete natyrore të jashtëzakonshme. Parku i Tiranës karakterizohet nga një diversitet bimor i konsiderueshëm, nga një bimësi e larmishme dhe florë e pasur. Nga

studimet e kryera janë përcaktuar rreth 400 lloje bimore që përfaqësojnë rreth 250 gjini e rreth 70 familje, të cilat paraqesin vlera të shumanshme si: zbukuruese, mjekësore, ngjyruese, të rralla, të rrezikuara etj. Struktura e ambienteve të gjelbëruara që funksionojnë si parqe, rekreacione dhe lulishte publike për qytetin e Tiranës shtrihet e gjitha në një sipërfaqe totale 2,761,538 m², e ndarë në rreth 61 struktura të gjelbra, ndër më të rëndësishmet janë:

- Sipërfaqja e gjelbër në qendër të Tiranës zë një hapësirë rreth 240,026 m²;
- Parku i madh bashkë me liqenin artificial shtrihen në një sipërfaqe të konsiderueshme prej 1,590,000 m². E ndarë nga kjo sipërfaqe ndodhet si i vetmi në Shqipëri, Kopshti Zoologjik me sipërfaqe 59,600 m²;
- Varrezat e Dëshmorëve dhe kjo një sipërfaqe kryesisht e gjelbër shtrihet në 249,700 m²;
- Parku Rinia që zë një sipërfaqe prej 30,000 m².

Hapësirat e gjelbërta ndalojnë erozionet, thithin sasi të mëdha të ujërave të shiut, duke na mbrojtur nga përmytjet. Pemët janë absorbuesit kryesor të ndotjes, të paktën 20 pemë mund të thithin tymin e një makine që qarkullon rreth 100 km. Parqet dhe zonat e gjelbërta zbusin efektet serë të zonave urbane aty ku ndërtesat asfalti dhe betoni thithin rrezatimin diellor, duke e reflektuar atë në formën e nxehtësisë më të madhe dhe temperaturave më të larta. Janë pikërisht parqet dhe zonat e gjelbërta që frenojnë rritjen e temperaturave të larta në qytete. Pemët reduktojnë efektin e ngrohjes dhe nëpërmjet hijes së tyre. Hapësirat e gjelbra sigurojnë vendbanim për një larmi shpendësh, kafshësh, insektesh dhe organizmash të tjera, duke siguruar korridore të gjelbërta për të lidhur habitatet. Hapësirat e gjelbra zvogëlojnë ndotjen dhe nga zhurmat nëpërmjet degëve të dendura të pemëve dhe shkurreve izolojnë zhurmat dhe pastrojnë pjesërisht ujërat e zeza. Hapësirat e gjelbërta dhe banorët janë treguesi më i mirë i shëndetit të përgjithshëm dhe cilësisë së jetesës në qytet. Hapësirat e përbashkëta kanë një rol jetik në çlodhjen dhe argëtimin e banorëve. Hapësirat e gjelbërta mes pallateve janë thelbësore për funksionimin e një komuniteti. Ato nxisin lidhjet dhe komunikimin mes banorëve, stimulojnë pozitivisht me ngjyrat dhe aromën e këndshme duke afruar natyrën me qytetin, dhe njerëzit me natyrën. Përfitimet e komunitetit nga hapësirat e gjelbërta janë të panumërta.

Tema 13: Projektimi i hapësirave të gjelbra

Projektimi i hapësirave synon gjelbërimin e zonave dhe ndërtimin e hapësirave të gjelbra. Kjo bëhet sipas projektit ku paraqiten në planimetri me detaje specifike me të gjithë elementet që duhet ti përgjigjen kërkesave të sotme për mjedise të gjelbërta çlodhëse e argëtuese. Punimet parapërgatitore të ndërtimit të zonave të gjelbërta janë gërmime për sistemimin e vendit ku do të zbatohet projekti, largimi i elementeve vegjetative të panevojshëm. Gërmimet shoqërohen me evadimi e një sasi të konsiderueshme të dherave e mbetjeve nga demolimet, kryesisht copëra betoni, gurë, dhera e sipas rastit tokë me vegjetacion të degraduar e spontan.

Sipërfaqet e gjelbërta kufizohen sipas rastit me bordura betoni dhe koridore qarkulluese me pllaka. Vendosen stola për banoret e frekuentuesit e zonës së gjelbëruar. Zona pajiset me ndriçim të përshtatshëm dekorativ e bashkëkohor, me ndriçues të kohës që shpenzojnë minimalisht energjinë elektrike. Shtresa e punueshme duhet të ketë karakteristikat fiziko-kimike për të siguruar një zënie të sigurt dhe zhvillim të bimëve barishtore, shkurre apo pemë, me pH neutral, të pajisur mirë me materie organike dhe ushqyesve, cilësi të mesme, pa gurë. Kur shtresa është bërë nga toka jo të kultivuara, thellësia e tërheqjes së materialit duhet të jenë të përfshirë në shtresën e eksploruara nga rrënjët e specieve barishtore të pranishme dhe në çdo rast nuk

duhet të kalojë një gjysmë metër. Kompania para se të marre dherat e ti shperndaje për shtrese, duhet të dergojë mostrat në një Stacion agrokimik të njohur për të bërë analizat sipas standardeve për parametrat e analizës së tokës.

Tema 14: Mënyrat e kombinimit të bimëve zbukuruese dhe barit

Kur mendojmë për arkitekturën zakonisht na vjen në mendje beton, hekur, xham, gur, por gjelbërimi ka luajtur gjithmonë një rol shume të rëndësishëm. Arti i organizimit të kopshteve është i vjetër sa njerëzimi dhe projektimi i peisazhit është një fushë e rëndësishme në arkitekturë. Por rëndësia e gjelbërimit nuk qëndron vetëm tek vlerat estetike dhe roli dekorativ, ka dhe një rol të rëndësishëm në formulimin e hapësirave cilësore për të jetuar të cilat janë jo vetëm vizualisht të këndshme por edhe të shëndetshme për njeriun si në aspektin fizik dhe atë psikologjik. Gjelbërimi luan rol kryesor në përmirësimin e mikroklimës, përmirësimin e cilësisë së ajrit, reduktimin e efektit të ishullit të nxehëtisë që vjen na përdorimi i gjerë i materialeve me kapacitet të lartë akumulues të nxehtësisë si psh betoni, guri etj. Kjo është vecanërisht e rëndësishme sot kur Tirana vuan nga mungesa e hapësirave të gjelbra. Lidhur me aspektin psikologjik, gjelbërimi ka efekt pozitiv në shëndetin mendor dhe humorin e mirë të njerëzve, stimulon shqisat me ngjyrën, aromën dhe lëvizjen, duke bërë që qëndrimi në një zonë të gjelbër të jetë i këndshëm dhe relaksues. Zonat e gjelbra përbëjnë hapësira për grumbullim dhe ndërveprim midis njerëzve duke patur kështu dhe një benefi të rëndësishëm social. Hapësirat e gjelbra projektohen me vemendje të vecantë duke u bërë një vlerë e shtuar për rezidencat e banimit në harmoni dhe respekt të plotë me natyrën. Nxjerrjen e bimëve nga fidanishtja duhet të bëhet me të gjitha masat e nevojshme për të shmangur dëmtimin e rrënjëve kryesore dhe në përputhje me teknikat e duhura për të ruajtur sistemin e gjerë rrënjor dhe për të shmangur dëmtimet. Nxjerrja kryhet me dorë ose në mënyrë mekanike. Mbjelljen nuk duhet të kryhet në periudhën e ngricave. Përveç kur parashikohet ndryshe në kushtet e veçanta të kontratës dhe kushteve, mbjelljen e pemëve është në mes të mes të Tetorit dhe mesit të Prillit. Në qoftë se duhet të behen shkurtime të nevojshme të pjesës ajrore të bimës, kjo do të duhet të kryhet në mënyrë që të sigurohet një ekuilibër në mes të vëllimit të rrënjëve dhe grupin e degëve. Mbjellja e drureve duhet te behet me tutore per ta mbajtur drejt trupin gjate rritjes ne vitet epara. Hapja e gropave për drurët e rritur (me trungun me perimenter të paktën 18 deri në 20 cm) dhe haloret të paktën 3 m në lartësi: 1m x 1m x 1m; - Drurët e rinj: 0.7m x 0.7m x 0.7m - Shkurre: 0.50m x 0.50m x 0.50m;

Drurët Ata duhet të kenë pjesën ajrore të mbajtur në formë të rregullt, të ngjashme me drurët e rritur në mënyrë spontane, për të nxitur një rritje të fuqishme, të shpejtë duke e vaditur e plehëruar. Pemët do të duhet për të përmbushur specifikimet e përcaktuara, në përputhje me karakteristikat e saj.

- Perimetrin i trungut
- Lartësinë totale
- Lartësia e degës me te ulëtt



- Diametri i kurorës në degëzime
- Dendësia e gjetheve, numri mesatar i degëve anësore në trung

Kjo pastaj do të vazhdojë për mbjelljen e bimëve nga bar shumëvjeçar me përdorimin e 200 kg farë për hektar të sipërfaqes.

Tema 15: Përkujdesja për hapësirat e gjelbra

Banorët e qyteteve prekin çdo ditë nga afër ndryshimin rrënjësor që është bërë falë investimeve të bashkisë. Sipërfaqe të gjelbëruara, ndriçim stola, si dhe kënde lojrash për fëmijë të ze syri në shumë lagje të qytetit në qendër dhe periferi. Puna e bashkisë dhe e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike ka qënë e vazhdueshme për mirëmbajtjen e tyre. Bashkia po punon për hapjen e puseve të reja të cilat do të mundësojnë vaditjen e lulishteve, shtimin e stolave të rinj si dhe vendosjen e ndriçuesve modernë dhe ekonomikë.

Shërbimet kryesore në hapësirat e gjelbra

- mbjellja e pemëve dekorative dhe barit të lulishtës
- ujijtjet e pemëve dhe barit
- plehërimi i barit dhe bimëve dekorative
- prerja e barit
- krasitja e pemëve dekorative
- punimi i tokës për rreth kurorës

Tema 16: Bimët kryesore aromatike

Sherebela (*Salvia officinalis*) është bimë shumëvjeçare me gjelbërim të përhershëm, kërcell drunor, gjethe gri, dhe lule blu në vjollcë. *Salvia* është gjini e familjes Labiate dhe rajoni i saj autokton është Mesdheu, megjithëse është aklimatizuar në shumë vende të botës. Sherebela ka një histori të gjatë të përdorimit në mjekësi, në artin e kuzhinës dhe në kohët moderne si bimë dekorative në kopshte. Vlerësohet si Mbretëresha e bimëve mjekësore. Malësia e Madhe është treva ku ka zanafillën kultivimi i sherebelës në Shqipëri. Ajo shtrihet në zonën veriperëndimore të vendit. Arsyet kryesore të kultivimit të sherebelës janë:

- Kërkesa e tregut dhe çmimet favorizuese
- Mbështetje me subvencione kryesisht në mbulimin e shpenzimeve të mëdha gjatë vitit të parë të kultivimit
- Areale tokësore të përafërta me ato të habitateve natyrore
- Cilësia e materialit mbjellës dhe e prodhimit me tregues të principeve aktive që plotësojnë më së miri kërkesat e standardeve të kërkuara nga tregu.
- Rënia e rezervave natyrore si pasojë e shfrytëzimit pa kriter.

Sherebela në vendin tonë është në shtëpinë e saj. Shqipëria ka diversitet të lartë të kësaj bime, por më të kërkuara në treg janë ekotipet e zonës së Veriut të Shqipërisë. Rajoni Shkodrës paraqitet si një ndër më të pasurit me ekotipet e sherebelës që shquhen për tregues të lartë të principeve aktive. Nga ana tjetër këto ekotipe si ai i Taraboshit, i Hotit, i Velipojës, kanë një përshtatshmëri dhe prodhimtari të lartë në kushte kultivimi në Zonën e Mbishkodrës. Duke marrë në konsideratë kushtet e përshtatshme, kërkesën e tregut dhe interesin ekonomik të kultivimit, një sipërfaqe e

konsiderueshme rreth 1500 ha në zona si Kukës, Gjirokastrë, e Dibër, mund të kultivohet me sukses bima e sherebelës duke i dhënë këtyre zonave një mundësi të konsiderueshme zhvillimi ekonomik e social. Sot pjesa më e madhe e sherebelës që eksportohet, mbi 70% e saj vjen nga kultivimi në tokat e fermerëve. Bima e sherebelës parapëlqen toka neutrale ose lehtësisht gëlqerore e ranore, të përshkueshme në mënyrë që të favorizojë një drenazhim të mirë e një qarkullim të ajrit në tokë. Duke patur parasysh se sherebela është bimë shumëvjeçare, kultivohet 5-6 vite në të njëjtin terren, është e nevojshme të eliminohen gabimet në zgjedhjen e tokës pasi investimet janë shumë të larta. Përgatitja e fidanit të sherebelës është zgjat rreth 3 muaj duke filluar me përgatitjen e tokës për mbjellje, hedhjen e farës e mbulimin e saj, ujitjen, mbrojtjen e bimëve nga barërat e këqija, sëmundjet e dëmtuesit, etj. Parcela e zgjedhur për farishte duhet të jetë e kulluar mirë. Plugimi për farishten e sherebelës kryhet me kujdes në thellësinë 25-30 cm. Plugimi mund të kryhet në vjeshtë ose para mbjelljes. Përgatitja e shtratit të farës Para mbjelljes, parcela diskohet ose frezohet. Duhet të kemi kujdes dhe të sigurojmë një nivelim të mirë. Më pas vazhdohet me ndërtimin e vllajave me gjerësi 1.3-1.5 m të cilat ndahen nga njëra tjetra me brazda me thellësi 20-30 cm. Për të krijuar një shtrat sa më të përshtatshëm, vllajave i bëjmë një rulim me mjete të thjeshta për të ngjeshur shtresën e sipërme të tokës. Pas ngjeshjes dhe nivelimit të vllajës, mbi këtë strukturë të ngjeshur shpërndahet fara me një normë 10-12 gram për m². Me këtë normë fare sigurohen rreth 600-700 fidanë/m². Është e rëndësishme ti kushtohet një vëmendje e veçantë pozicionimit të farës e cila nuk duhet të vendoset thellë. Mbi farën e shpërndarë, hidhet një shtresë dheu rreth 0.5 cm në rastet e ujitjes me pika dhe deri 1 cm trashësi në rastet e ujitjes me lagëse dore. Pas hedhjes së dherishtes kryhet edhe një ngjeshje e dytë me rul apo dërrasë e sheshtë për të evituar “hapësirat ajrore” rreth farës. Në rastin e mbjelljeve me bikerina aplikohet. Temperaturat më të mira për mbirje janë 15-20 gradë C. Temperaturat më të larta e shpejtojnë por mund të ndeshim probleme me uniformitetin e mbirjeve dhe të zhvillimit të fidanëve. Gjatë zhvillimit të bimëve në farishte është e nevojshme që të eliminohen barërat e këqija si dhe disa bimëza sherebele të dobëta. Zakonisht harrja e barërave të këqija realizohet me dorë.

Shumëzimi me copa, përgatitja e fidanëve. Copat merren në majat vegjetative në gjatësi 8-10 cm, në bimët 2-3 vjeçare të zgjedhura si tipike. Copat vendosen në shtretër për rrënjëzim, me dendësi shumë të madhe, 400-500 copa për m². Rekomandohet prerja me brisk ose thikë të mprehtë për të evituar dëmtimet dhe duhet të kemi kujdes që mjeti që përdoret për prerje të jetë i pastër dhe i dezinfektua. Fidanët e përgatitur në këtë mënyrë ruajnë tipicitetin e varietetit dhe kanë aftësi zënëse shumë të mirë. Në praktikën e kultivimit të sherebelës jemi ndeshur në përdorim direkt si material mbjellës, pa i shtratifikuar apo trajtuar, copa të marra në habitate natyrore apo parcela të kultivuar 2-3 vjeçare. Tokat të destinuara për kultivimin e sherebelës duhet të punohen në thellësi 40-50 cm. Është mirë që ky proces të realizohet gjatë verës duke ulur mundësinë e shfaqjes së barërave të këqija në vitet pasardhëse. Para mbjelljes së fidanëve të sherebelës toka duhet të frezohet apo diskohet si dhe të eliminohen disnivelet e terrenit. Plehërimi para mbjelljes. Plehërimi realizohet në dy forma: plehra organike dhe ato kimike. Më të mirat janë ato organike. Ato duhet të jenë të mirëdekompozuar, të mos kenë rezerva farore të barërave të këqija. Dozat e plehërimit variojnë nga 300-400 kv/ha. Kur përdorim plehra organike të shpendëve kjo dozë përgjysmohet. Plehtrat kimike që përdoren në plehërimin bazë janë potasike dhe fosforike në doza 120-150 kg lëndë aktive K dhe 80-90 kg lëndë aktive P. Mbajllja e fidanëve në fushë realizohet në dy sezona, në vjeshtë dhe pranverë. Mbajllja realizohet me rresht me gjerësi 60-70cm dhe largësi ndërmjet bimëve 25-30cm për të siguruar jo me pak se 55-60 000 bimë/ha. Nga studimi i realizuar me variantet: 6, 7 dhe 8 bimë/m², të realizuara në distanca mbajlljeje 70 x 24cm, 70 x

20cm dhe 70 x 18cm, rezulton mbjellja bëhet në vjeshtë dhe në pranverë, por me rezultate më të mira është mbjellja e vjeshtës sepse shfrytëzohen dhe shirat e stinës. Shërbimet intensive fillojnë që në vitin e parë. Prashitjet, heqja e barërave të keqija, plehrimet plotësuese, etj.

Afati i vjeljes së sherebelës së kultivuar përcaktohet nga dy kritere bazë: marrja e prodhimit maksimal gjetho dhe vlera më e lartë e principeve aktive. Prodhimi më i madh merret me vjeljen e parë (qershor) 8-10 ton/ha masë të njomë. Prodhimi i dytë në vjeshtë është më i vogël, 6-7 ton/ha. Tharja realizohet menjëherë pas vjeljes, në hije, duke ruajtur në vlera maksimale përmbajtjen e principeve aktive. Vjelja e dytë e cila përkon me sezon lagështie e temperatura të ulëta, tharja realizohet në hangarë të mbuluar dhe me ajrim të mirë. Ruajtja e masës së thatë deri në dorëzimin e saj bëhet në ambiente të thata e të ajrosura.

Kamomili është bimë barishtore pranverore deri 60cm. Emrat krahinorë: Kamomil, Kamumile. Emërtimi shkencor: *Matricaria recutita* L. Lulja e kamomilit ka ngjajshmëri me lulledelen por është më e vogël se ajo dhe petalet e bardha i ka të varura poshtë, ndërsa gjysëmsfera me thekë vendoset si kupolë e verdhë në qëndër të rrethit me petale. Gjendet mjaft e kufizuar nëpër qëndrat e banuara dhe veçanërisht përreth oborreve të shtëpive përdhese nëpër fshatra. Të gjithë e njohin mjaft mirë dhe e ruajnë për t'i mbledhur lulet gjatë muajit Maj kur ajo ka kohën e lulëzimit të plotë. Pjesa që mblihet: lulet pa bisht Maj-Qershor. Duhet bërë kujdes që kamomili të grumbulluar në oborre e kopshte të cilat nuk janë spërkatur me preparate kundra sëmundjeve e dëmtuesve, pasi arsyeja përse Shqipëria e humbi tregun e eksportit 30 vite më parë ishte pikërisht konstatimi i mbetjeve të fosforit dhe klorit në kamomilin e rritur në oborre. Lulet keputen me dorë duke e lënë bishtin e tyre në bimë, hidhen në një trashë bezeje dhe shpihen për t'u tharë. Tharja bëhet në ambiente të mbrojtura në hije. Çdo tre-katër orë lulet përziejnë që të thahen shpejt dhe uniformisht. Pastaj ambalazhohen në thasë bezeje të cilët vendosen mbi dyshe druri të thatë në rastin e ambienteve familjare të grumbulluesve në terren. Në rastin e tharjes në ambientet e magazinave apo depove të posaçme, tharja kryhet në banda bezesh apo në trina. Ambalazhimi për eksport bëhet në arka kompensate.

Trëndafili i Egër është shkurre 1.5 m. Emrat krahinorë: Ferrë kaçë, trëndafil i egër. Emërtimi shkencor: *Rosa canina* L. Gjethet vezake të dhëmbëzuara në anët e tyre. Kërcejtë më gjëmba të shumtë. Lulet ngjyrë rozë ose të bardha që çelin në Maj-Korrik. Frutat në formë vezake të zgjatura, ngjyrë të kuqe ose të errët kur piqen plotësisht në muajt e vjeshtës. Përhapet kudo dhe shkon deri në 1500m mbi nivelin e detit. Rritet në përzierje me lloje të tjerë si murrizi, frashëri, mretja, ilqja por edhe i vetmuar. Preferon toka gurishtore të pasura me gëlqerorë. Pjesët që vilen: frutat Tetor-Nëntor kur të kenë ngjyrë të kuqe të thellë ose vishnje. Vjelja bëhet me dorë duke përdorur dorashka doku të fortë për t'u mbrojtur nga gjëmbat e shumtë të degëve. Nuk lejohet krasitje apo prerje e degëve të bimës. Mblihen frutat e arrirë dhe të fortë pa kërcell. 20% e frutave duhet të lihen për përtëritje. Frutat mund të thahen të plotë ose të ndarë përgjysmë. Frutat e vjela vendosen për t'u tharë në vënde të ajrosur dhe të mbrojtur nga pluhurat apo ndotjet prej kafshëve dhe shpendëve. Ruajtja e kokrrave të thara bëhet në thasë bezeje.

Trumza e malit është shkurre e vogël 30 cm. Emri krahinorë: Trumzë. Emërtimi shkencor: *Satureja montana* L. Gjethet heshtake ngjyrë jeshile pak e hapur. Lulet të bardha. Çelin në periudhën Qershor-Shtator. Rritet në masive të kufi zuar ku formon dëndësi të madhe në numur bimësh siç janë faqet rrëzë maleve, skarpitet e përrejtje, vëndet zhavorrina, rrungajat çakullore dhe shkëmbijtë gëlqerorë. Shkon deri në lartësinë 1200m mbi nivelin e detit. Preferon kryesisht shullanët shkëmborë dhe gurishtorë që i rreh dielli gjatë ditës. Vilen gjethet Qershor-Shtator gjatë periudhës së lulëzimit. Bimët korren me drapër në gjatësi 10-15cm kur bima është në lulëzim të plotë. Duhet që 30% e popullatës të mos preket. Më pas futen nëpër thasë dhe transportohen në

shtëpi ku hapen për t'u tharë në vënde pa hijezuara, të ajrosur dhe të pastër. Pas tharjes, bimëve u shkoqen gjethet së bashku me lulet.

Borziloku (*Ocimum basilicum*, familja Labiatae)- është një bimë popullore e Mesdheut që ka vlera ushqimore dhe mjekësore, të cilave i janë thurur lavde që në lashtësi. Ai ka një shije delikate e të ëmbël, madje dhe pak djegëse, por më të butë se rigoni. Borziloku rritet në mbarë Mesdheun dhe në Evropën e Jugut. Edhe Shqipëria ka një traditë të lashtë në kultivimin e borzilokut jo vetëm nëpër kopshte, por edhe në vazo në kushtet e shtëpisë. Kjo bimë ka shumë fitonutrientë, minerale, vitamina që janë të rëndësishme për shëndetin dhe mirëqenien e njeriut. Shumë prej elementëve kimikë që gjenden tek borziloku kanë vlera të mëdha kundër inflamacionit dhe baktereve. Borziloku i freskët ka vitaminë C dhe në 100gr të tij gjendet 86% e dozës së rekomanduar ditore të kësaj vitamine të rëndësishme që shërben si antioksidant dhe lufton radikalet e lira. Acidet e pranishme tek borziloku forcojnë imunitetin, përshpejtojnë shërimin e plagëve dhe luftojnë virozat. Bima e borzilokut ka nivele të larta beta karoteni, vitamina A, luteine dhe zeaxanthine, të cilët janë flavonoidë antioksidantësh të fuqishëm. Vitamina A është thelbësore për shëndetin e mirë të syve dhe të lëkurës. Konsumimi i ushqimeve të pasura me vitaminë A dhe karoten mbron njeriun nga disa lloje tumoresh si ai i mushkërive. Borziloku është një nga barishtet më të pasura me vitaminë K. Në 100 gr gjethe të thata borziloku gjenden 518% të dozës së rekomanduar ditore të kësaj vitamine e cila luan një rol të rëndësishëm për forcimin e kockave dhe mbrojtjen e tyre. Barishtja përmban një sërë mineralesh të tjera të rëndësishme siç janë hekuri, kalciumi, kaliumi, mangani, bakri, zinku dhe magnezi. Për më tepër këto gjethe janë burim i shkëlqyer hekuri. Në 100gr gjethe borziloku gjenden 82.71 mg Fe ose 10-34% të dozës së rekomanduar ditore.

